



AGJENCIA KOMBËTARE  
E ARSIMIT, FORMIMIT  
PROFESIONAL DHE  
KUALIFIKIMEVE

# PRAKTIKA PROFESIONALE NË VENDIN E PUNËS

## Udhëzues



Maj 2016

*Porositur nga:*

Programi i GIZ-it për AFP-në

*Përgatitur nga:*

Illir Aliko, nën drejtimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë  
dhe Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

*Publikuar nga:*

Deutsche Gesellschaft für

Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Rr. "Ismail Qemali", Pall. 18, Kati 4, Apt.20, Tirana, Albania

T: +355 4 22 55 397

F: +355 4 22 48 533

I: <http://www.giz.de>

Tiranë, Maj 2016

I dashur lexues,

MMSR-ja vijon me përkushtim zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014–2020, e aprovuar nga qeveria shqiptare, që synon “Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë, femrat dhe meshkujt”. Politikat dhe reformat institucionale që kemi ndërmarrë po riorientojnë arsimin dhe formimin profesional drejt nevojave reale të tregut kombëtar dhe rajonal të punës.

Mbështetur në modelet dhe praktikat më të mira të vendeve Europiane, që aplikojnë sistemin dual të arsimit dhe formimit profesional, MMSR-ja dhe agjencitë e saj zbatuese në nivel qendror dhe lokal konsiderojnë pjesë të rëndësishme të punës ndërtimin e partneritetit të qëndrueshëm dhe fleksibël me të gjithë aktorët e tregut të punës, dhe veçanërisht biznesin, për të mundësuar të nxënit në vendin e punës dhe tranzicionin e lehtë të të rinjve në tregun e punës.

Udhëzuesi që po prezantohet, vjen në një moment shumë të rëndësishëm të formëzimit të partneritetit ndërmjet institucioneve publike të AFP-së dhe biznesit, dhe synon të informojë punëdhënësit, prindërit, të rinjtë e të rejtat që kryejnë arsimin dhe formimin profesional, mbi mundësitë dhe kuadrin ligjor në fuqi për realizimin e praktikave profesionale në biznese dhe institucione të ndryshme publike dhe private.

Gjej rastin të falënderoj të gjitha kompanitë e biznesit që i janë bashkuar nismës sonë, dhe ftoj komunitetin e biznesit në të gjithë Shqipërinë të hapin dyert për të rinjtë dhe të rejtat për të zhvilluar praktikat profesionale, duke dhënë kështu një kontribut të madh dhe të pazëvendësueshëm në rritjen e cilësisë së AFP-së, uljen e papunësisë të të rinjtë dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë.

Së fundi, dua të falënderoj stafin e MMSR-së, AKAFPQ-në, SHKP-në, ISHP-në, përfaqësuesit e institucioneve publike të AFP-së, përfaqësuesit e bizneseve, ekspertët vendorë dhe Programin e GIZ-it për Arsimin dhe Formimin Profesional për hartimin e Udhëzuesit dhe realizimin e një procesi konsultimi bazë të gjerë.

Sinqerisht,  
  
BLENDI KLOSI



# PËRMBAJTJA

1. ÇFARË ËSHTË PRAKTIKA PROFESIONALE?	6
2. KORNIZA LIGJORE	8
Marrëveshje ndërmjet palëve	8
Sigurimi nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale	8
Mbrojtja e të miturve në punë	8
Siguria dhe shëndeti në punë	9
Libreza shëndetësore	9
Vlerësimi i praktikës profesionale në vendin e punës	9
3. SI TË ORGANIZOHET SA MË MIRË PRAKTIKA PROFESIONALE?	10
3.1. Rekomandime të përgjithshme për organizim	10
Modeli i kontratës	10
Koha e praktikës	10
Kostot e transportit	11
Karta e identifikimit	11
Programi i praktikës	11
Vlerësimi final	11
3.2. Çfarë është mirë të bëjë biznesi apo institucioni?	11
3.3. Çfarë është mirë të bëjnë nxënësit?	12
3.4. Çfarë është mirë të bëjë shkolla?	13

# 1. ÇFARË ËSHTË PRAKTIKA PROFESIONALE?

Praktika profesionale në vendin e punës është të nxënët përmes punës së mirëfilltë në një mjedis të vërtetë pune për të prodhuar të mira materiale ose për të ofruar shërbime.

*Përse është kaq e rëndësishme?*

Gjatë praktikës profesionale në vendin e punës nxënësit vihen në provë, zhvillojnë dhe konsolidojnë aftësitë dhe njohuritë e domosdoshme për ushtrimin e profesionit. Në të njëjtën kohë, gjatë këtij procesi nxënësit zhvillojnë kulturën e punës, personalitetin dhe ndjenjën e përgjegjësisë.

Ofruesit e vendeve të praktikës profesionale mund të jenë biznese, por, në varësi të degës profesionale, mund të jenë edhe institucione private apo shtetërore.

Praktika profesionale në vendin e punës nuk është me përfitim vetëm për nxënësit; prej saj po ashtu përfitojnë edhe bizneset, institucionet dhe shkollat.



Bizneset apo institucionet ofruese të praktikës përfitojnë, sepse:

- *nxënësit janë punëtorë me kosto të ulët, pasi kontribuojnë për të prodhuar ose për të ofruar shërbime, sidomos nëse qëndrojnë në praktikë në një afat më të gjatë;*
- *kanë rastin të njohin nxënësit nga afër dhe të verifikojnë sa të përshtatshëm janë si punonjës të ardhshëm.*

Shkollat përfitojnë, sepse:

- *rritet cilësia e programeve dhe rezultateve mësimore, meqenëse marrin peshë të madhe aftësitë që janë më të rëndësishme për situatat e punës reale dhe përditësimi i tyre;*
- *arsimi profesional bëhet më tërheqës për shoqërinë, meqenëse të rinjtë kanë rastin të përjetojnë vetë lidhjen e përmbytjes mësimore me punën reale.*

Nxënësit përfitojnë, sepse:

- *kanë mundësi të familjarizohen me botën e punës dhe ta kenë më të lehtë tranzicionin nga shkolla në punë;*
- *marrin aftësi dhe kompetenca të domosdoshme në punë, përfshirë ato që lidhen me komunikimin, punën në grup, zgjidhjen e problemeve, dhe shprehitë themelore të punës si përpikmëria etj.;*
- *krijojnë dhe forcojnë kontaktet me punëdhënësit, ekspertët e fushës si dhe informohen më shumë për zgjedhjet e karrierës.*

## 2. KORNIZA LIGJORE

Aktualisht, kuadri ligjor në fuqi parashikon disa rregullime ligjore të detyrueshme për praktikën profesionale në vendin e punës:

### Marrëveshje ndërmjet palëve

Praktika profesionale e nxënësve në biznese apo institucione duhet të rregullohet nëpërmjet një marrëveshjeje trepalëshe midis nxënësit, shkollës dhe biznesit apo institucionit (shih ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar).

### Sigurimi nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale

Biznesi apo institucioni duhet ta sigurojë nxënësin për kohën e programuar të praktikës profesionale pa pagesë, në masën 0.3% të pagës bruto minimale, e barabartë me **66 lekë në muaj**, vetëm për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale. Kjo duhet të përfshihet në kontratën e lidhur ndërmjet palëve (shih ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 28.01.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”).

### Mbrojtja e të miturve në punë

Në rastin e nxënësve që janë të mitur, të cilët kryejnë praktikë profesionale, biznesi apo institucioni nuk ka nevojë të marrin autorizim të posaçëm nga Inspektorati i Punës. Kohëzgjatja e punës në këto raste është e kufizuar në 6 orë në ditë dhe 30 orë në javë (shih Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 20.5.1996, i ndryshuar me VKM nr. 205, datë 9.5.2002, “Për mbrojtjen e të miturve në punë”).



## Siguria dhe shëndeti në punë

Të gjithë nxënësit, të mitur apo të rritur, duhet të mbrohen nga punët që vënë në rrezik mirëqenien dhe zhvillimin e tyre. Nisur nga rreziqet specifike, biznesi apo institucioni duhet të marrë masat e nevojshme në mbrojtje të sigurisë dhe të shëndetit në punë për të gjithë (shih ligjin nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”).

## Libreza shëndetësore

Në rastet kur praktika profesionale zhvillohet në biznese prodhimi dhe shërbimi, ku mund të ketë rrezikshmëri për përhapje të sëmundjeve ngjitëse, nxënësit duhet të pajisen me librezë shëndetësore nga Inspektorati Sanitar Shtetëror (shih ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”).

## Vlerësimi i praktikës profesionale në vendin e punës

Vlerësimi final i nxënësve për praktikën profesionale duhet të bëhet në bashkëpunim me biznesin apo institucionin ku është zhvilluar praktika (shih Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 169, datë 8.05.2014, “Për disa ndryshime në dispozitat normative për sistemin arsimor parauniversitar”).

## 3. SI TË ORGANIZOHET SA MË MIRË PRAKTIKA PROFESIONALE?

Përveç rregullimeve ligjore më lart, për t'i bërë praktikat profesionale me sa më shumë përfitim për të gjitha palët, rekomandohet të merren parasysh disa aspekte kyç.

### 3.1. Rekomandime të përgjithshme për organizim

#### Modeli i kontratës

Ndonëse nuk ka një model kontrate të detyrueshme, është e nevojshme të mbahet parasysh që ajo të përmbajë të paktën elementet që vijojnë:

- ➔ Identitetin dhe adresën e të trija palëve;
- ➔ Periudhën, ditët javore dhe orarin ditor;
- ➔ Profilin e praktikës profesionale;
- ➔ Detyrimet dhe te drejtat e palëve;
- ➔ Nënshkrimet, datën dhe vulën e shkollës.

Kur kompania ka vetë një model kontrate të përshtatshme, mund të përdoret edhe ajo.

Kjo kontratë e nënshkruar duhet të jetë në tri kopje.

#### Koha e praktikës

Shkolla këshillohet të organizojë praktikat profesionale në mënyrë që t'i përshtaten sa më mirë biznesit apo institucionit. Në përgjithësi kompanitë preferojnë më tepër praktikat e grupuara në blloqe kohore, sesa shpërndarjen e tyre gjatë gjithë vitit shkollor, në disa orë gjatë javës.

## Kostot e transportit

Në rastet kur nxënësit praktikantë duhet të udhëtojnë me mjete transporti për të shkuar te biznesi apo institucioni, atëherë mbulimi i kostove të transportit të nxënësve duhet të diskutohet dhe të bihet dakord mes palëve, para fillimit të kohës së praktikës.

## Karta e identifikimit

Për ta bërë më të lehtë identifikimin e nxënësve në praktikë profesionale edhe prej autoriteteve që kontrollojnë detyrimet e biznes ndaj shtetit, është mirë që ata të pajisen nga shkolla dhe të mbajnë të ekspozuar një kartë identifikimi.

## Programi i praktikës

Bazuar në programin e moduleve profesionale dhe/ose projekteve të të nxënit duhet të hartohet bashkërisht nga shkolla dhe biznesi apo institucioni një **Program i praktikës profesionale në biznes apo institucion**. Programi duhet të përmbajë një listë sa më të plotë punimesh apo shërbimesh, kompetencash dhe njohurish që i shërben biznesit apo institucionit, për ta lidhur sa më mirë praktikën në vendin e punës me programin që realizohet në shkollë.

## Vlerësimi final

Vlerësimi final i nxënësve, edhe pse është i detyrueshëm (shih më lart *Korniza ligjore*), nuk ka një model të caktuar për të bërë **vlerësimin final** të praktikës në bashkëpunim me biznesin apo institucionin.

Modeli i vlerësimit final duhet të jetë individual për çdo nxënësi, të marrë parasysh elementet reale të performancës së tyre gjatë praktikës dhe në të njëjtën kohë të jetë i thjeshtë për t'u plotësuar nga biznesi apo institucioni.

## 3.2. Çfarë është mirë të bëjë biznesi apo institucioni?

Biznesi apo institucioni këshillohet:

- t'i zgjedhë vetë nxënësit praktikantë, pra, fillimisht, mund të intervistojë nxënësit për të vlerësuar potencialin e tyre dhe për të përshtatur praktikën profesionale me vendin e punës;

- të caktojë një specialist të saj si mentor, i cili të jetë me aftësi profesionale dhe cilësi personale që garantojnë një praktikë profesionale të përshtatshme dhe pa rreziqe për shëndetin dhe moralin e nxënësve.

Specialisti apo mentori këshillohet:

- të kërkojë prej nxënësve kryerjen e detyrave të thjeshta të cilat bëhen më komplekse me kalimin e kohës. Ai/Ajo duhet të bëjë përsëritjen e detyrave në mënyrë të alternuar, që në fund të praktikës nxënësit të jenë në gjendje të kryejnë në mënyrë të pavarur dhe në një kohë të arsyeshme sa më shumë punime e shërbime të përmendura në programin e praktikës profesionale;
- të instruktojë vazhdimisht nxënësit për rregullat e sigurimit teknik;
- t'u mësojë nxënësve respektimin e disiplinës dhe rregullit të brendshëm të biznesit apo institucionit;
- të njoftojë menjëherë shkollën për çdo problem që mund të krijohet me nxënësit.

### 3.3. Çfarë është mirë të bëjnë nxënësit?

Nxënësit këshillohen:

- ta konsiderojnë kohën e praktikës në vendin e punës si një mundësi të mirë për të rritur aftësitë e tyre dhe gjetjen e një punësimi të ardhshëm;
- të jenë të përgatitur për t'u intervistuar nga bizneset apo institucionet për aftësitë profesionale, synimet e karrierës etj.;
- të frekuentojnë rregullisht praktikën profesionale sipas programit dhe kontratës, të jenë të përpiktë dhe të respektojnë disiplinën e punës së biznesit apo institucionit;
- të mbajnë të ekspozuar kartën e identifikimit gjatë gjithë periudhës së praktikës profesionale;
- të justifikojnë mungesat e mundshme si të gjithë punonjësit e tjerë të biznesit apo institucionit;

- të respektojnë me rigorozitet të gjitha rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë që ka vendosur biznesi apo institucioni;
- të zbatojnë udhëzimet e specialistit të kompanisë, të kryejnë me ndërgjegje punët që u caktohen dhe të ruajnë sekretin profesional;
- të shënojnë në fletoren e praktikës çështjet me interes, siç mund të jenë: procedura të caktuara pune, receta të ndryshme, skema apo informacione të reja etj., pra, të përdoret si një mjet mësimnxënies;
- të kenë sjellje korrekte dhe të mësohen me rregullin në ambientet e punës, saktësinë dhe punën e pastër.

### 3.4. Çfarë është mirë të bëjë shkolla?

Shkolla këshillohet:

- të verifikojë përshtatshmërinë e ambienteve në biznes apo në institucion;
- të kufizojë numrin e nxënësve që dërgon në një biznes apo në një institucion në përpjesëtim me numrin e specialistëve që ai ka, në mënyrë që nxënësi të kontribuojë drejtpërdrejt në punët e biznesit apo të institucionit;
- të sigurojë që kontrata trepalëshe të jetë arritur dhe firmosur përpara fillimit të praktikës profesionale;
- t'i udhëzojë nxënësit për t'u përballur me intervista në biznese apo në institucione;
- t'i informojë nxënësit përpara fillimit të praktikës, por edhe gjatë realizimit të saj, për detyrimet dhe të drejtat e tyre, rregullat e sigurisë në punë, frekuentimit të praktikës, sjelljes, mënyrës së veshjes, disiplinën, peshën që kanë mungesat, mbajtjen e fletores së praktikës, kriteret dhe formën sipas të cilës do të vlerësohet praktika, peshën që ka ky vlerësim në kuadrin e të gjitha detyrimeve të nxënësit për të kaluar klasën etj.;
- të organizojë pajisjen e nxënësve me **librezë shëndetësore** në rastet kur praktika profesionale zhvillohet në biznese apo në institucione që

e kanë detyrim pajisjen e punonjësve të tyre me librezë shëndetësore nga organet e Inspektoratit Sanitar Shtetëror (shih më lart *Korniza ligjore*);

- të vërë në dispozicion të nxënësve **fletore të praktikës** ose së paku një format të saj (është përvojë e mirë që gjatë kryerjes së praktikës nxënësit të mbajnë fletore për praktikën), në të cilën të shënojnë sistematikisht çdo gjë me interes që hasin gjatë punës;
- të caktojë një mësues për të monitoruar nxënësit gjatë praktikës në vendin e punës, ku gjatë monitorimit të bëhen takime me nxënësit, të verifikohet frekuentimi dhe shkalla e përfitimit prej praktikës, të kontrollohet fletorja e praktikës etj. si dhe të merren masa korrigjuese kur është e nevojshme;
- të konsultohet, përmes mësuesit përgjegjës, me specialistë nga biznesi apo institucioni për përmbushjen e programit të praktikës dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mundshme me nxënësin gjatë realizimit të praktikës në vendin e punës etj.;
- të ndërtojë një bazë të dhënash për kompanitë partnere, të cilën e pasuron vazhdimisht vit pas viti, nëpërmjet bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet ofruese të vendeve të praktikës.



### **Faqe interneti që mund t'ju shërbejnë:**

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinise <http://www.sociale.gov.al/>

Shërbimi Kombëtar i Punësimit <http://www.kerkojpune.gov.al/>

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve <http://www.akafp.gov.al/>

Inspektorati Shtetëror i Punës <http://sli.gov.al/>

Konfederata e Punëdhënësve të Shqipërisë “BIZNESALBANIA” <http://www.biznesalbania.org.al/>



Implemented  
by **giz**  
Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH